

VENDIM
Nr. 126, datë 4.4.2023

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “M&K ENERGY TRADING CO” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9 pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 40/5 prot., datë 30.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k.”.

konstatoi se:

- Shoqëria “M&K Energy Trading Co” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 200, datë 3.8.2022, për një afat 5-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 40/4, datë 21.3.2023, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, për transferimin (nëpërmjet dhurimit) të 25.5% të kuotave të zotëruara nga ortaku i shoqërisë Z. F Q, te Z. V Q, dhe transferimin (nëpërmjet dhurimit) të 25.5% të kuotave nga ortaku i shoqërisë, Z. K Q, te Z. V Q. Duke qenë se shoqëria tashme e ka kryer transferimin e kuotave para marrjes së miratimit nga ERE, ajo shprehet se në kuadër të këtij gabimi është e gatshme për të kthyer strukturën e kuotave në gjendjen e mëparshme në rast të mosmarrjes të këtij miratimi nga ERE.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.

- Shoqëria “M&K Energy Trading Co” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k.

2. Ortaku kryesor i shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k., me 51% të kuotave të kapitalit, bëhet z. Viktor Qylafi.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që

mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli